



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 21 korrik 2026

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1.Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për përmbajtjen dhe formën e regjistrit elektronik të koncesioneve dhe partneritetit publik privat”	2
2. Projektvendimi ” “Për miratimin e rregullave për vlerësimin, dhënien, ndryshimin dhe transferimin e kontratave të koncesionit partneritetit publik privat”	3
3.. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave” Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore” të ndryshuar	3
4. Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” të ndryshuar	4
5. Projektvendimi “Për një ndryshim dhe disa shtesa ne vendimin nr. 466 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave” Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit të Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit” i ndryshuar.....	5
6. Projektvendimi “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030”.5	
7. Projektvendimi “Për masën e pagesës për familjen kujdestare dhe për fëmijët e vendosur nën kujdesin alternativ në familje”.....	6.
8. Projektvendimi “Për organizimin , funksionimin, dhe aksesin në regjistrin elektronik për kujdesin alternativ në familje”.....	7
9. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026-2030”.....	7
10. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të saj, si dhe modelit të certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit”.....	7
11. Projektudhëzimi “Për caktimin e kriterëve për përpilimin e listave, mënyrën e hartimit të skedave përshkruese për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore objekt verifikimi të interesit kulturor dhe dërgimit të tyre”.....	8
12. Projektvendimi “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i prodhimit të ujit” Sh.a dhe përcaktimin e rregullave për organizimin, periudhën tranzitore dhe fillimin e veprimtarisë së saj”.....	9
Shtojcë:	
Të pranishëm	10

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 21 korrik 2026 u zhvillua mbledhja e tetë e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua online, në platformën Teams, ku morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve dhe pa humbur kohë ja kaloi fjalë përfaqësueseve për prezantimin e akteve të propozuara nga ministrinë e linjës.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për përmbajtjen dhe formën e regjistrimit elektronik të koncesioneve dhe partneritetit publik privat”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Z. Genti Seci, Specialist, Drejtoria e Koncesioneve dhe Partneriteteve sqaroi se REKP është një bazë të dhënash elektronike e centralizuar, me akses publik dhe pa pagesë, për të gjitha kontratat e koncesionit dhe PPP në Shqipëri. Administrrohet nga Institucioni Përgjegjës dhe ndërvepron automatikisht me QKB-në e cila ekziston për të mbyllur boshllëkun e informacionit për kontrata aktive, për të monitoruar rreziqet fiskale, si dhe për të siguruar transparencë në kuadër të integritetit në BE, e cila përmban të dhëna bazë si Autoriteti kontraktues, objekti, lloji, vendndodhja, kohëzgjatja, vlera e investimit, tarifa etj. Dokumentacioni përmban tekstin e plotë të kontratës, shtojcat, garancia, studimi i fizibilitetit, ndryshimet/transferimet dhe raportet e monitorimit. Ndërsa, afatet dhe detyrimet e bashkive (si Autoritet Kontraktues) janë

- 15 ditë: Dorëzimi i dokumentacionit të plotë pas nënshkrimit të çdo kontrate të re.
- 15 ditë: Dorëzimi i dokumentacionit pas çdo ndryshimi apo transferimi të kontratës.
- 30 ditë: Dorëzimi i të gjitha kontratave ekzistuese (*legacy*) të nënshkruara para hyrjes në fuqi të VKM-së.

Dorëzimi i raporteve periodike nga Njësia e Zbatimit të Kontratës (NjZK) jo më pak se 4 herë në vit.

Z. Seci theksoi pikat kryesore për Bashkitë. Bashkia ka detyrim ligjor t'i përmbahet afateve, për ndryshe përballat me sanksione administrative, si dhe duhet të ngarkojë të gjitha kontratat ekzistuese aktive brenda 30 ditëve. Raportet e monitorimit të bashkisë bëhen publike automatikisht në REKP. Nuk ka nevojë për dyfishim të dhënash, pasi të dhënat e partnerit privat merren automatikisht nga QKB.

Komente nuk ka

2. **Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për vlerësimin, dhënien, ndryshimin dhe transferimin e kontratave të koncesionit partneritetit publik privat”,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Z. Genti Seci, Specialist, Drejtorja e Koncesioneve dhe Partneriteteve i cili sqaroi se Risitë dhe Fleksibiliteti për Bashkitë janë;

Bashkitë kanë të drejtë t'i kërkojnë Institucionit Përgjegjës (ATRAKO) hartimin e studimit të fizibilitetit. Bashkia cakton vlerën e garancisë së ofertës sipas rrezikut të projektit (jo me normë fikse, por me tavan deri në 2%). Tarifat e koncesionit që mblihen kalojnë drejtpërdrejt në buxhetin e bashkisë. Përsa i përket kufirit të aktiveve vlera totale e kontratave nuk mund të kalojë 5% të aktiveve të bashkisë dhe kufiri vjetor neto nuk mund të kalojë 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit të kaluar. Çdo projekt me mbështetje financiare kërkon miratim të detyrueshëm nga Ministria e Financave.

Detyrimet Kryesore për Bashkitë janë;

- Ngritja e Komisionit: Ngritja e Komisionit të Koncesionit/PPP-së për çdo projekt.
- Ngritja e NjZK: Krijimi i Njesisë së Zbatimit të Kontratës për çdo kontratë aktive (përfshirë kontratat ekzistuese brenda 6 muajve).
- Raportimi dhe Monitorimi: Raportim periodik (min. 4 herë në vit) pranë ATRAKO-s dhe Ministrisë së Financave, me sanksione administrative në rast moszbatimi.

Projekti ka 5 Fazat si;

- Identifikimi: Raporti paraprak dhe përfshirja në Listën Unike nëse kalon limitin (15M EUR).
- Fizibiliteti: Analiza teknike/financiare e vlerësimit të impaktit në buxhetin vendor.
- Miratimi i MF: Miratimi paraprak dhe ai final pas negocimit.
- Tenderi: Procedurë konkurruese (me 1 ose me faza/negocim).
- Kontrata & Monitorimi: Nënshkrimi, ngritja e NjZK-së dhe monitorimi i vazhdueshëm.

Komente nuk ka

3. **Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave” Për përcaktimin e kritereve të procedurës dhe dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore” të ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Z. Alqi Kushi, Drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Z. A Kushi përmendi qëllimin e projektaktit si;

- Thjeshtimi dhe përmirësimi i procedurave administrative.
- Digjitalizimi i plotë i procesit të aplikimit dhe konkurrimit.
- Rritja e transparencës, efikasitetit dhe gjurmueshmërisë në administrimin e pasurive shtetërore.

- Harmonizimi me kuadrin ligjor në fuqi.

Ndërsa sqaroi Procedurën e Konkurrimit Digjitalizimin që përmban;

- Dorëzimin elektronik ku ofertat dhe dokumentacioni dorëzohen vetëm në adresën zyrtare elektronike të institucionit, duke eliminuar plotësisht dorëzimin fizik në fazën e parë si dhe reduktohen vonesat procedurale dhe kostot administrative, si dhe rritet transparencja nëpërmjet regjistrimit elektronik. Pas shpalljes së fituesit, kërkohet dorëzimi fizik i dokumentacionit origjinal për të konfirmuar vlefshmërinë e dokumenteve të paraqitura elektronikisht dhe për të parandaluar abuzimet.

Ndryshimet Kryesore Procedurale dhe Teknike

- Unifikimi i terminologjisë: Termi *“tokë e pafrytshme”* zëvendësohet me *“tokë inproduktive”* për harmonizim me legjislacionin në fuqi.
- Afati i dokumentacionit: Dokumentet tekniko-ligjore duhet të jenë të lëshuara ose të përditësuara brenda 3 muajve të fundit.
- Ofertat e pakërkua: Dhënia e drejtpërdrejtë lejohet vetëm në rastet e parashikuara në vendim dhe kërkon me patjetër një relacion të arsyetuar shoqërues.

Z.Kushi u ndal te rregullimet për kontratat "1 Euro" dhe monitorimi ku për pasuritë në zona me përparësi zhvillimin e turizmit dhe zona të mbrojtura mjedisore, propozimet bëhen në bashkëpunim midis përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore dhe institucionit përgjegjës për fushën përkatëse. Saktësohen kushtet dhe procedurat për kalimin e kontratave ekzistuese në kontrata me tarifë simbolike 1 Euro me qëllim nxitjen e investimeve. Njësia monitoruese merr të drejtën të propozojë zgjidhjen e kontratës në rastet kur vërehet mosbashkëpunim nga ana e qiramarrësit/përdoruesit.

Komente nuk ka

- 4. Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 926, datë 29/12/2014, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” të ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Z. Alqi Kushi, Drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit i cili theksoi se;

Akti standardizon rregullat për kalimin e pronësisë përmes privatizimit për ministrinë, institucionet qendrore, organet e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare shtetërore si dhe lehtëson procedurat e procesit të privatizimit të pronave shtetërore. Në akt përcaktohen qartë të gjitha pasuritë që u nënshtrohen procedurave (pronat e paluajtshme, të luajtshme, objektet e veçanta, mjetet kryesore/xhiros dhe asetet e shoqërive tregtare të zbritura nga kapitali). Akti rrit transparencën me detyrim për njoftim dhe afishim publik të fillimit të çdo procedure privatizimi, si dhe riorganizon komisionin e vlerësimit ku përcaktohet roli i strukturës përgjegjëse dhe lejohet përfshirja e ekspertëve apo audituesve të jashtëm për raste me kompleksitet të lartë.

Akti përcakton rregulla të veçanta për ngritjen e komisionit dhe kryerjen e vlerësimit bazuar në verifikimin faktik në terren për pronat në administrim të subjekteve që nuk ekzistojnë më si dhe përcaktohet bashkëpunimi zyrtar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për sigurimin e dokumentacionit, statusit juridik dhe verifikimin e kufizimeve gjyqësore apo administrative.

Në akt sqarohet përmirësimi i procedurave të publikimit të ankandëve, funksionimi i komisionit të ankandit dhe garantimi i të drejtave të ish-pronarëve dhe rregullohen procedurat se si do të veprohet për pronat e pashitura, mungesën e dokumentacionit në dosje, si dhe hapat standardë për lidhjen dhe ekzekutimin e kontratës së shitjes.

Komente nuk ka

5. Projektvendimi “Për një ndryshim dhe disa shtesa ne vendimin nr. 466 datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave” Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit të Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit” i ndryshuar, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Znj. Anxhela Bushati, Përgjegjës Sektori, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit,

Znj. Bushati theksoi se akti ka për qëllim krijimin e një mjedisi më konkurrues për biznesin, nxitja e transformimit industrial dhe integrimi në tregun e vetëm evropian dhe për të përmbushur angazhimet e Kapitullit 20 të BE-së (“*Politikat Industriale dhe NVM-të*”), për të reflektuar rekomandimet e Komisionit Evropian dhe për të zgjatur periudhën e zbatimit deri në vitin 2030. Ndryshimet Kryesore dhe Fushat e Ndërhyrjes janë;

- Zgjatet afati deri në vitin 2030, përditësohet Plani i Veprimit me kuadrin financiar dhe shtohen 15 masa të reja prioritare (duke e çuar numrin total në 30 masa).
- Transformimi industrial, tranzicioni i gjelbër, dixhitalizimi, inovacioni, standardizimi, zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe konkurrueshmëria e ndërmarrjeve.

Asnjë ndryshim kompetencash: Strategjia nuk ndryshon apo prek kompetencat ligjore të pushtetit vendor. Bashkitë shërbejnë si partnerë strategjikë për krijimin e mjedisit të favorshëm ekonomik lokal, mbështetjen e investimeve në territor, koordinimin e infrastrukturës dhe dialogun me biznesin lokal. Akti sjell rezultatet e pritshme si;

- Rritje e konkurrueshmërisë, eksporteve dhe produktivitetit të ekonomisë.
- Zhvillim i një industrie moderne e të qëndrueshme dhe përshtetshme për integrimin evropian.

Komente nuk ka

6. Projektvendimi “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030” propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u prezantua nga Znj. Ilsa Dede, Specialist, Sektori Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazimin Gjinor, e cila theksoi se agjenda ndërtohet mbi arritjet e periudhës 2021–2026, rekomandimet e OKB-së (CRC 2023), Raportin e Progresit të BE-së (2025) dhe standardet e integritetit evropian dhe garanton të drejta të barabarta, mbrojtja nga çdo formë dhune/diskriminimi dhe krijimi i mundësive për zhvillim të plotë për çdo fëmijë. Ky proces për hartimin e axhendës

është zhvilluar përmes 1 procesi të gjatë konsultimi ndërinstitutional, i cili është kordinuar nga grupi ndërinstitutional i punës i ngritur me urdhër të ministrit për shëndetësinë dhe mirëqenie sociale, si dhe me pjesëmarrjen e institucioneve përgjegjëse të për të drejtat, mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, si dhe janë zhvilluar konsultime me 74 fëmijë nga qytete të ndryshme të vendit dhe njëkohësisht, duke përfshirë këtu edhe fëmijët të cilët kanë statusin e vëzhguesit në këshillin kombëtar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

Znj. Dede përmendi tre qëllimet strategjike që janë;

- Qeverisja e forcuar: Mekanizma më të fortë koordinues, monitorues dhe financues në nivel qendror e vendor.
- Eliminimi i dhunës: Parandalim, reagim i shpejtë, shërbime të integruara rehabilitimi dhe drejtësi miqësore për fëmijët.
- Mirëqenie dhe mundësi të barabarta: Akses në arsim e shëndetësi, përshejtim i deinstitutionalizimit dhe transformim digjital etik.

Gjithashtu, risitë kryesore të aktit janë;

- Siguria digjitale dhe mbrojtja e fëmijëve online.
- Shëndeti mendor dhe shërbimet e specializuara me fokus te parandalimi.
- Përfshirja e drejtpërdrejtë e vetë fëmijëve në vendimmarrje dhe politika të bazuara në evidenca.

Për sa i përket kuadrit financiar ndahet;

- Buxheti i Shtetit: ~1.29 miliardë lekë.
- Donatorët/Financim i huaj: ~331 milionë lekë.
- Hendeku Financiar: ~371 milionë lekë

Komente

Z. Dritan Lika, Drejtor për financat e bashkisë Fushë-Arrëz shtroi që problemet sociale janë gjithmonë në rritje. Punonjësit e shtuar të bashkive si; koordinatori i dhunës për fëmijë, referuesi, punonjësi i shërbimit të social, etj...ndërkohë që flasim bashkitë në të gjitha këto procese nuk kanë rol vendimmarrje. Në rastin e familjeve kujdestare që paguhet me 1 pagë minimale, do të ishte mirë që përveç pagës duhet të paguheshin edhe sigurimet shoqërore. Për çdo shtesë në shërbimet sociale duhet mbështetje financiare për bashkitë, pasi siç u përmend është kosto e shtuar si numri i punonjësve për mbulimin e këtyre shërbimeve.

7. Projektvendimi “Për masën e pagesës për familjen kujdestare dhe për fëmijët e vendosur nën kujdesin alternativ në familje”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u prezantua nga Nertila Topulli, Drejtor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Znj. Topulli sqaroi se akti siguron një pagesë mujore prej 12,000 lekësh për nevojat e përditshme, një pagesë vjetore prej 35,000 lekësh për shpenzime individuale, si dhe mbështetje të diferencuar

për fëmijët me aftësi të kufizuara (me mekanizëm indeksimi vjetor). Prindi aplikues punësohet pranë bashkisë me kontratë sipas Kodit të Punës dhe përfiton pagesë mujore në nivelin e pagës minimale në fuqi. Pagesat fillojnë pas vendimit gjyqësor dhe lidhjes së kontratës, ndërsa të gjithë përfituesit regjistrohen në sistemin elektronik

Komente nuk ka

8. Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin, dhe aksesin në regjistrin elektronik për kujdesin alternativ në familje”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u prezantua nga Nertila Topulli, Drejtor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e cila sqaroi se;

Akti krijon i kuadrin rregullator për regjistrimin, administrimin dhe aksesin në një bazë të dhënash digjitale të unifikuar për të gjitha raste e fëmijëve në kujdes alternativ dhe administrohet funksionalisht nga Shërbimi Social Shtetëror, teknikisht nga AKSHI, ndërsa bashkitë janë përgjegjëse për hedhjen e të dhënave brenda 7 ditëve pune. Ndërvepron me sisteme si e-Albania, Gjendja Civile, ISSH, e Regjistri i Llogarive. Aksesin bëhet me kredenciale individuale dhe me gjurmueshmëri të plotë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komente nuk ka

9. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026-2030”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit u prezantua nga **Znj. Borana Kalemi**, Këshilltare e Ministrit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit e cila theksoi se hartimi i strategjisë mbështetet në analizën e kuadrit institucional, agjendat ndërkombëtare dhe konsultimet e gjera (metoda Delphi me eksperte, takime me ekspertë dhe Forumin e Hapur me 100 profesionistë) dhe strukturohet në reforma ligjore, programe, veprime teknike dhe përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkive.

Znj. Kalemi përmendi tri shtyllat kryesore;

- Cilësia e Jetës: Kultura si shtysë për angazhimin e publikut dhe zhvillimin socio-ekonomik.
- Dialogu Ndërkombëtar: Promovimi i dinamizmit kulturor shqiptar në skenën globale.
- Faktori Mundësues: Përmirësimi i kuadrit ligjor, ngritja e kapaciteteve dhe digjitalizimi i ekosistemit.

Përfshirja e Bashkive është mbrojtja e trashëgimisë kulturore jo-materiale (TKJ), zhvillimi i muzeve dhe ringjallja e kullave tradicionale dhe krijimi i Këshillave Bashkiake të Pjesëmarrjes Kulturore, Karta Universale e Muzeve dhe programe të dedikuara për fëmijët e pakicat. Buxheti Total 5-vjeçar: ~34.85 miliardë lekë dhe burimet e financimit nga buxheti i shtetit (i rialokuar dhe alokime të reja), fonde ndërkombëtare/BE, stimuj privatë/fiskalë dhe partneritete publik-privat.

Komente nuk ka

10. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të saj, si dhe modelit të certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit u prezantua nga Z. Elton Orozi, Drejtor, Drejtoria e Standardeve të Turizmit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, theksoi qëllimin e aktit për krijimin e një kuadri të unifikuar për zhvillimin e agroturizmit, duke përcaktuar kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për dhënien, ripërtëritjen, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave, si dhe rregullat për ndërtimin e strukturave ndihmëse dhe ngritja e Task-Forcës Ndërinstitucionale për menaxhimin e fluksit të turistëve dhe mbarëvajtjen e sezonit.

Z. Orozi u ndal në efektet e aktit si;

- Zhvillim i qëndrueshëm rural përmes integritit të turizmit me bujqësinë, blegtorinë, peshkimin dhe akuakulturën.
- Rritje e investimeve, krijim i vendeve të reja të punës dhe promovim i produkteve e traditave vendase.
- Krijimi i një sistemi transparent certifikimi, reduktimi i barrës administrative dhe forcimi i monitorimit.
- Nxitja e ekonomisë lokale dhe rritja e konkurrueshmërisë së produkteve vendore.
- Përfshirja aktive e të rinjve dhe grave në sipërmarrjen rurale.

Komente nuk ka

11. Projektudhëzimi “Për caktimin e kriterëve për përpilimin e listave, mënyrën e hartimit të skedave përshkruese për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore objekt verifikimi të interesit kulturor dhe dërgimit të tyre”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit u prezantua nga Znj. Sonila Kora, Specialist, Drejtoria e Trashëgimisë Materiale.

Znj. Kora sqaroi se akti bazohet në Ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", i ndryshuar (neni 58, pika 2) dhe ka për qëllim standardizimin dhe unifikimin e procedurës për identifikimin, dokumentimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme shtetërore që mund të kenë interes kulturor në të gjithë vendin. Përfshihen pasuritë shtetërore që plotësojnë të paktën një nga këto kushte:

- Janë të ndërtuara mbi 70 vjet më parë.
- Mbajnë vlerë historike, artistike, arkitektonike, arkeologjike ose etnografike.
- Janë pjesë e qendrave historike, ansambleve apo zonave arkeologjike, ose figurojnë në dokumente arkivore/hartografike

Akti përcakton formatin e Listës së Pasurive (Aneksi I) dhe Skeda Përshkruese e detajuar (Aneksi II).

Institucioni administrues (p.sh. NJVV) përgatit listën, skedat dhe dosjen teknike/fotografike. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) verifikon dokumentacionin brenda 15 ditëve

pune (dhe kërkon plotësime brenda 10 ditëve pune nëse nevojitet). Pas deklarimit si pasuri kulturore, të dhënat kalojnë për regjistrim në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore (RKPK).

Znj. Kora përmendi rolin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) si;

- Identifikojnë pasuritë shtetërore në territorin e tyre, hartojnë listat/skedat përshkruese dhe mbledhin dokumentacionin përkatës.
- Bashkëpunojnë me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe IKTK-në për mbrojtjen e trashëgimisë lokale.

Gjithashtu, u ndal në rezultatet e pritshme të aktit si;

- Unifikim i procedurave dhe krijimi i një baze të dhënash të besueshme në nivel kombëtar.
- Koordinim më i mirë mes pushtetit qendror e vendor dhe mbështetje e vendimmarrjes për mbrojtjen e trashëgimisë

Komente nuk ka

12. Projektvendimi “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i prodhimit të ujit” Sh. a dhe përcaktimin e rregullave për organizimin, periudhën tranzitore dhe fillimin e veprimtarisë së saj”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë u prezantua nga Z. Ermal Murati, Drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i cili sqaroi se shoqëritë e ujësjellësit janë reduktuar nga 58 në 15 Shoqëri Rajonale UK.

Në vijim shtoi rezultatet e fazës I (Aktuale):

- Uji pa të ardhura (humbjet) u ul nga 65.1% në 60.1% (-5.0%).
- Norma e arkëtimit u rrit nga 89.9% në 103.4% (+13.5%).
- Shlyerja e faturave korrente të energjisë arriti në 93.0%.
- Efienca e stafit u përmirësua nga 5.3 në 4.6 punonjës për 1000 lidhje.

Arsyeja e Fazës II: Megjithë përmirësimet, prodhimi i ujit dhe infrastruktura strategjike mbeten të fragmentuara.

Gjithashtu, krijimi i OPU ndan përgjegjësitë pa cënuar marrëdhënien e qytetarit me operatorët rajonalë: OPU (Operatori i Prodhimit të Ujit) menaxhon prodhimin, transmetimin dhe investimet strategjike në nivel kombëtar. Shoqëritë Rajonale UK vijnë menaxhimin e shpërndarjes, furnizimit dhe shërbimit ndaj konsumatorit.

Vlera e shtuar e OPU është;

- Teknike që përfshin; Operim i unifikuar, monitorim i centralizuar (sisteme SCADA për monitorim në kohë reale) dhe laboratorë të certifikuar për cilësinë e ujit dhe;
- Ekonomike: Optimizim kostosh, ekonomi shkalle dhe përdorim më efikas i investimeve.
- Qeverisëse & Strategjike që ndan qartë e rolet, rritje e sigurisë së burimeve ujore dhe planifikim afatgjatë.

Struktura e OPU, bën inventarizimin e aseteve, standardizimin e procedurave dhe përcaktimin e modelit investues, si dhe rrit efencën operationale, optimizon koston dhe rritjen e kapaciteteve në marrëdhënie me shoqëritë UK dhe krijon siguri afatgjatë të furnizimit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, rezistencë klimatike dhe teknologji moderne.

Komente nuk ka

1. Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje të zhvilluar me datën 21 korrik 2026

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Edona Bilali	Zv/ministër	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
3	Elda Xhumari	Zv/ministër	Ministria e Mjedisit
4	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë

Bashkëlidhur gjeni linkun e projektakteve që u diskutuan;

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/21-korrik-2026/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.